



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. 12854/1 Prot

Lezhë, më 21.07.2025

Relacion për Projekt Vendimin mbi "Plani Vendor për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2025-2030"

Projekti vendimi është hartuar në mbështetje të Ligji Nr. 10/2012 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" garanton të drejta të barabarta dhe mbrojtje nga çdo formë diskriminimi në të gjitha fushat e jetës. Gjithashtu, Ligji Nr. 96/2017 "Për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë" njohu komunitetet rom dhe egjiptian si pakica kombëtare, duke u garantuar atyre të drejtën për të ruajtur kulturën, gjuhën dhe traditat. Shqipëria është angazhuar gjithashtu përmes Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës, e ratifikuar në vitin 2000, dhe është pjesë e Deklaratës së Poznanit (2019) në kuadër të Procesit të Berlinit, ku janë përcaktuar objektiva të qarta për integrimin e romëve në Ballkanin Perëndimor.

Objekti i këtij Projekt-Vendimi është miratimi i Planit të Vendor për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2025-2030" i cili qëndron në rolin e tij si një udhërrëfyes për vendimmarrësit lokalë dhe partnerët strategjikë për të adresuar barrierat e pabarazisë dhe për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës ku të gjithë qytetarët e Bashkisë Lezhë të kenë mundësi të barabarta.

Ky plan paraqet një hap të rëndësishëm drejt garantimit të të drejtave të barabarta, përmirësimit të aksesit në shërbime dhe fuqizimit të pjesëmarrjes qytetare të komuniteteve romë dhe egjiptiane në nivel vendor.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

NË MUNGESË DHE ME URDHER

ZV.KRYETARE

Brikena VUKSANI

